

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti II i botimit, Korrik 2008 Nr. 15. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



MEDIAT SHQIPTARE U KRIJOJNË HAPËSIRA EKSTREMISTËVE ANTIMUSLIMANË

Në studiot televizive, telespektatori shqiptar ka qene deshmitarë i njëanshmërisë kur keto studio jane venë në dispozicion të diskutimit te temave që kanë patur të bëjnë me probleme që kanë qenë te lidhura me fenë islame dhe me muslimanët. Vazhdimisht aty janë pare duke diskutuar të njëjtat figura të cilat po përfaqësojnë në media opinjonin e politikës shqiptare dhe atë të publicistikës shqiptare, duke qenë të blinduar nga një mbrojtje e hapur e atyre që i drejtojnë këto emisione. Ajo që është shumë shqetësuese lidhet me mungesën e pales që penalizohet në këto emisione duke e rritur edhe më shumë shkallën e këtij penalizimi dhe diskriminimi. Kujtojmë debatet që u bënë për vendosjen e bustit të Tereze Bojaxhiut në Shkodër, të cilat bënë që në media të ngrihet një stuhi sulmesh dhe fyerjesh nga më të rëndat për shoqatat muslimane që dhënë një mendim alternativ për vendosjen e këtij bust ,alternativë që u mirëprit dhe u aprovua nga këshilli bashkiak në Shkodër që e largoi bustin nga hyrja e qytetit. Në këtë linjë u bënë edhe diskutimet në studiot e televizioneve qendrore si Klani dhe Top Chenell për romanin provokues të politikanit socialist Ben Kiço Blushit i cili u botua si një traktat i mirëfilltë antimusliman dhe do të mbetet i tillë, sepse ata që e inspiruan dhe ata që e ndihmuan të dalë në qarullim këtë kolerë antiislame ia paten bërë një portret të tillë që kur ky roman u piketua që të shohë dritën e botimit. Ata, që i ndoqën diskutimet që u bënë në studiot e këtyre televizioneve, e dhënë vertiklin të rrugës që do të ndiqte paneli i ftuar sapo i pa ata që ishin ftuar ne këto diskutime. Ishin figura të njohura në mediat e shkruara dhe vizive që kanë kartabiankë për të botuar dhe për të folur atë që u është lejuar të shkruajnë dhe të flasin .Duke vazhduar të bëjmë portretin e tyre mund t'i quajmë analistë të programuar që nuk mund të dalin jashtë kornizave të caktuara, sepse rrezikohen



“që t’u pritet dita e punës”. Realisht këto misionë janë të planifikuara dhe të detajuara që të kenë atë konkluzion që duan ata që e tensionojnë situatën fetare në Shqipëri, për t’u treguar me katolikë se papa, duke menduar se edhe ata mund të marrin ndonjë “Medalje” për bema të tilla që nuk janë tullumbace, por janë goditje me rreze veprimi të gjatë të cilat dëshrojnë që t’u bin mbi kokë atyre që i projektojnë, i planifikojnë që edhe t’i zbatojnë. Në panel, për të shtrmbëruar të vërtetën, në studion e Tv Klanit ishin vënë njëri as tjetrit ,sepse nuk kishin lënë hapësirë që të kishin pale alternative përballë, Pirro Misha,që e nxori të pafajshëm Blushin e vogël me idenë se ai nuk ka faj për qëndrimet e personazheve sikur ata personazhe t’ia kishin montuar me dhunë në romanin e tij.Ndërsa ata që e kontestuan mesazhin atiislam të veprës së këtij ekstremisti ortodoks, për Mishën ishin njerëz që kishin jetuar në Lindjen e Mesme, duke i dhënë kësaj hapësire pamjen e një fronti antiperëndimor me të cilin duhet të jemi gjithmonë të konfrontuar.Pranë kësaj figure, të afirmuar si penalizues i fesë islame,

ishte ulur Sabri Godo, një tel i përdredhur i politikës shqiptare që jo rrallë thirret për të dëshmuar për besnikëri ndaj asaj linje qe është kundër muslimanëve .Godoja ,që ngjason pak edhe me Bollanon e Himarës, ishte i shqetësuar se ezani, që i bën thirrje muslimaneve të shkojnë në xhami për t’u falur, është një prishës i qetësisë publike që duhet ndaluar, duke na kujtuar me këtë qëndrim teserën e asaj partie që mbante ne xhep e cila i rrënoi sidomos xhamitë në vitin 1967.Të bënte sidomos përshtypje Henri Cili, që po bëhet i pranishëm me shumë për besnikëri ndaj linjave të caktuara politike dhe fetare ,se sa për aftësitë intelektuale që zotëron, Për Henrin nuk ka problem në se Blushi ka ofenduar dhe sulmuar muslimanët ,sepse ne jetojme në një hapësirë demokratike ku edhe kryqi në rrugën e Elbasanit është i motivuar,megjithëse ai nuk është shtyllë e tensionit të lartë që mund të vendoset ku të ketë arsye teknike për një veprim të tillë..Diskutimet i vazhduan Fuga dhe Xhufi të cilët, me prononcimet e tyre ne këtë panel, treguan se janë larg atyre parametrave që jemi mësuar

që t’i shom zakonisht në media, ku ata edhe mbajnë qëndrime të drejta për disa çështje fetare dhe kombëtare. Por, shija e hidhur që na lane pas këto diskutime të sheqerosura në favor të romanit të Blushit lidhet me censurën që po ushtrohet nga mediat shqiptare për të pranuar në hapësirat e tyre të shkruara dhe vizive qëndrimin e muslimanëve për probleme që lidhen me identitetin e tyre dhe me mbrojtjen e fesë islame nga sulme denigruese dhe te planifikuara nga qendra që qëndrojnë pas këtyre veprimeve, sepse këto veprime nuk janë inisiativa vetjake.Bëhen deklarata mediatike, ku marrin pjesë me dhjetra media dhe të nesërmen një terr informative i rrezikshëm i censonon ata që mendojnë se e gëzojnë lirinë e shtypit dhe të vizionit. Në studiot televizive po zbarkojnë taboret me analistë që kanë marrë pamjen e efendikonjëve të dikurshën që në media po bëjnë ligjin e Maliqit.Ndërsa jashtë studjove televizive rrijnë ata që akuzohen fyhen , poshtrohen dikriminohen duke u mohuar të drejtën që ata të mbrohen me mendimin e tyre alternativ. Është një paralelizëm me monizmin ,kur i akuzuari nuk kishte avokat ,sepse quhej i panevojshëm dhe pastaj qytetari e shihte vehten pas hekurave.Vetëm mediat shqiptare duket se nuk kanë shqetësim montimin i një neodiktature mediatke, e cila po asfikson mendimin e lire dhe po merr përsipër që disa qytetarë të jenë të mikluarit e saj , kurse disa të tjerë, që janë shumica e popullsisë, të jenë të censuruarit e saj. Ne besojmë në vlerat e demokracisë e cila i ka vënë kokëposhtë gjithmonë diktaturat dhe neodiktaturat si dukuri të regresit dhe të dështimit të përparimit shoqëror.Në këtë kuadër ne dëshrojmë dhe kërkojmë që mediat shqiptare të shkruara dhe vizive ta kapërcejnë këtë stanjacion të rrezikshëm mediatik dhe të bëhen tribunë e fjalës dhe e mendimit të lire që janë dhe misioni i vërtetë i saj.

Selim Gokaj
Shkodër ,me 25 .6.2008

PAS “HAKMARRJES MITOLOGJIKE” SERBE QENDROJNE RUSET, JO TURQIT
ABDI BALETA

fq. 2

DISA ARGUMENTE PER BESIMTARET MUSLIMANE
ABDULKADIR HAKTANER

fq. 3

ALEANCA SHQIPARO-TURKE NE LUFTEN E SHKODRES
1912-1913
BAJRAM XHAFA

fq. 4

PROSIA E HASAN EL BENNA

fq. 5

JOSHJET E MASHTRIMIT
BURHAN FILI

fq. 7

MUSLIMANIZMI DHE EVROPIANIZMI
FATOS LUBONJA

fq. 8

Pas “hakmarrjes mitologjike” serbe qëndrojnë rusët, jo turqit

Abdi Baleta

Pas disfatës së austriakëve në Kosovë dhe ardhjes në drejtim të perandorisë si vizir i madh i shqiptarit Mehmet Qypriju, njëri nga vizirët e mëdhenj më të shquar, perandoria serish e mori për një kohë veten. Në vend të “rikonkuistës” së krishterë në Ballkan u përshpejtua dhe u masivizua procesi i myslimanizimit të shqiptarëve. Do të kalonin edhe 300 vjet pas kësaj që serbët e prirë nga Milosheviçi të tentonin “betejën vendimtare” të hakmarrjes mitologjike serbe në Kosovë për disfatat nga osmanët myslimanë dhe serbizimin etnik të Kosovës. Nën maskën e mbrojtjes së krishterimit evropian dhe të rikonkuistës në Ballkan Serbia e Milosheviçi kishin planifikuar dhe nisën të bënin në vitet 1998-99 spastrimin etnik e gjenocidin më të madh në historinë e Ballkanit kundër shqiptarëve. Këtë betejë Serbia e kishte shpallur qysh në vitin 1989, në 600 vjetorin e betejës së Fushë Kosovës dhe kur Milosheviçi vendosi anulimin e autonomisë së Kovoës në Jugosllavi. Këtë tragjedi e krim të paparë në Ballkan, të planifikuar nga Serbia, jo vetëm e kishte miratuar, por e përkrahu dhe e nxiti edhe Rusia.

Beteja e tretë, më e madhja për Kosovën, 600 vjet pas të parës dhe 300 vjet pas të dytës, përfundoi përsëri me një disfatë të rëndë për serbët në vitin 1999 kur NATO bombardoi Serbinë (SHBA superfuqia e kohës së sotme si Perandoria osmane në vitet 1389 e 1689-99)) dhe dëboi nga Kosova pushtuesit ushtarakë dhe administruesit civilë serbë. Si është puna e fatit!

Por si janë dhe “këshillat e djallit”(!). Ashtu siç shkruan Engjëlli Koliqi është njësoj si të fajsoh SHBA për shkatërrimet e humbjet njerëzore që pësoi Kosova gjatë fushatës së NATO-s për të dëbuar serbët nga Kosova, është njësoj sikur dëmshpërblimet për këto humbje t’ia kërkojnë SHBA-së e jo Serbisë. Pikërisht këtë propagandë kanë bërë politikanët e Beogradit e gjithë serbët për vite

me radhë, duke “fajsuar” me cinizëm e djallëzi NATO-n e SHBA për humbjet njerëzore që patën shqiptarët, për djegien e Kosovës dhe duke u përcjellë shqiptarëve “këshilla djalli” se po të shtrojnë kurrizin para Serbisë e të pranojnë ujdite që propozojnë serbët mund të fitojnë paqen e qetësinë. Vetëm kështu shqiptarët, sipas bojkotuesve serbë, mund të shpresojnë të udhëtojnë rehat nëpër Serbi, të pinë qumësht lopësh serbe, të hanë sallam derri serb e miell të hidhëruar, të bëjnë kontrabandë me serbët, të jenë bartës pasaportash serbe, të bëjnë tregti me Serbinë dhe të kenë energji elektrike nëpërmjet Serbisë. Ndryshe do të jenë të bojkotuar, të bllokuar, në errësirë, të uritur, të rrethuar e pse jo edhe të sulmuar nga paraushtarakë, banda dhe njësi të rregullta ushtarake serbe, apo “vullnetarë rusë”.

Kështu ata që nxisin sot ndjenja urrejtjeje ndaj Turqisë, ata që u thonë udhëheqësve kosovarë të mos çajnë më kokën për rreziqet që vinë nga Serbia e Rusia, por t’i shpallin “luftë diplomatike” Turqisë gjoja për të rregulluar “borxhet historike” që u ka shqiptarëve Perandoria Osmane, në fakt mbështesin politikën e propagandën serbe se nënkuptojnë që sherret midis shqiptarëve e serbëve po i bëka Amerika për interesat e saj. Serbët vazhdimisht kërkojnë e gjejnë tellallë, të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm, në radhët e shqiptarëve që t’i përcjellin opinionit publik shqiptar tezat dinake serbe se serbët e shqiptarët duhet të kenë gjithmonë një “armik të përbashkët” jashtëballkanik, se ky duhet të jetë armiku kryesor për shqiptarët, edhe kur këta vihen në shënjestër nga serbët. Ja pse dalin shkrime në shtypin e Shqipërisë që edhe në shekullin XIX armik kryesor i shqiptarëve të paraqitet Perandoria Osmane e jo Rusia, që edhe në shekullin XX armik i shqiptarëve të paraqitet Turqia e jo Serbia e Rusia, që edhe në shekullin XXI shqiptarët të rropaten për “borxhet historike” imagjinare që u paska Turqia, jo për borxhet e mëdha që u ka Serbia, të ruhen nga dashuria

për interes që tregon ndaj shqiptarëve Amerika, jo nga armiqësia e egër që po shfaq ndaj tyre Rusia.

Të gjitha këto duhen vendosur në sfondin e njohur historik, jo në trillimet propagandistike të atyre që duan të bindin shqiptarët të bëjnë mikun armik e të servilosen për dashamirësi nga armiku. Studiuesi amerikan i historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare, Zakari Karabell, shkruan pikërisht tani vonë se: “Osmanët e humbën gradualisht epërsinë që kishin dhe monarkitë e Europës dhe të Rusisë e përmbysën valën në fund të shekullit XVIII. Madje dhe atëherë Perandoria Osmane u lëkund por nuk u shemb” (“Njerëzit e librit. Historia e harruar e Islamit dhe e Perëndimit” 2007, fq.165) Pikërisht në këtë kohë Rusia i imponoi Perandorisë Osmane që në Traktatin e Kuçuk Kanarhisë (1774) të përfshihej klauzola që Rusia të njihë si mbrojtëse e popullsisë të krishtera ortodokse të Perandorisë Osmane, sikurse u njohën si mbrojtëse të tilla edhe Franca për katolikët dhe Anglia për protestantët.

Në të njëjtën kohë Perandoria dobësohej dhe nga pashallëqet e mëdha, gati si shtete më vete, që po krijoheshin me radhë nga Ali Pasha në Janinë, Bushatllinjët në Shkodër dhe sidomos Mehmet Aliu në Egjipt, pra të gjithë shqiptarë. Mehmet Aliu kërcënoi madje të rrëzonte Sulltanin e t’i zinte vendin dhe në vitin 1833 Sulltani iu drejtua Rusisë për ndihmë kundër Pashait shqiptar të Egjiptit. Ndërhynë Anglia dhe Franca për t’ia hequr këtë shans nga dora Rusisë, detyruan Mehmet Aliun të tërhiqej e të kënaqej me njohjen e të drejtës së një dinastie mbretërore të trashëgueshme të tij në Egjipt. Perandoria Osmane tashmë e kishte marrë emrin “i sëmuri i Bosforit” dhe Sulltani mbahej vetëm në saje të kontradiktave midis fuqive të tjera dhe të manovrimeve të shkëlqyera që bënin diplomatët e tij. “Osmanët ishin përballë faktit se ekzistenca e tyre e mëtejshme varej nga vendet evropiane që i

kishin shpëtuar më 1839 (libri i Karabell fq.210).

As reformat e Tanzimatit për modernizim, sipas modeleve evropiane, nuk sollën përmirësim të gjendjes, përkundrazi u shoqëruan me probleme të reja. Ishin përsëri Anglia dhe Franca që me luftën e Krimesë në vitin 1856 kundër Rusisë i dhanë frymëmarrje të re “ të sëmurit të Bosforit”. Fitorja e evropianëve dhe osmanëve në Luftën e Krimesë (ku kanë marrë pjesë dhe shqiptarë mirditorë të përfshirë në ushtrinë osmane me në krye Kapidanin e Mirditës) u shërbeu shumë edhe shqiptarëve për zgjimin e tyre kombëtar që kishte filluar me Pashallëqet e Mëdha të Janinës e Shkodrës, e sidomos me kryengritjen më të madhe shqiptare kundër osmanëve të prirë nga Dervish Cara në Pollog e Kosovë në vitet 1840. Sipas Natali Klejer lufta e Krimesë bëri që të zhvillohet në mënyrë të ndjeshme konteksti politik e shoqëror i Perandorisë Osmane, sidomos në pjesën ballkanike të saj dhe reformat e afirmimi i irredentizmave ballkanike që solli kjo luftë nxitën e kushtëzuan edhe ndërtimet e reja të shqiptarisë. (fq. 708). Pak kohë pas kësaj lufte në vitin 1861 rreziku serbo-grek për shqiptarët mori formën e marrëveshjes për ndarjen e trojeve shqiptare midis Serbisë e Greqisë (Klejer fq. 189), pra para se të bëhej ajo “marrëveshja e fshehtë” e Sulltanit me Carin. Marrëveshja e fshehtë serbo-greke ishte konkretizim i dy doktrinave ekspansioniste: të “Naçertanies” serbe dhe “Megaliidesë” greke. Për të ideuar e përpiluar “Naçertanien” që u lidh me emrin e serbit Garashanin (1854) puna kishte nisur qysh nga fundi i shekullit XVIII dhe kishin dhënë ndihmesën e tyre shumë teoricienë e veprimtarë të pansllavizmit nga disa vende sllave e priftëria serbe dhe fjetet tërhiqeshin nga njerëzit e oborrit të Carit rus.

Materiali është botura tek Gazeta Republika. Besimtari e boton me lejen e autorit.


Mirësevini në linjën e
punimeve artizanale
"Bilani"

Ne prodhojmë për ju punime
artizanale me aplikime, me
djegie dhe me gdhënie.

Prodhimet shiten me shumicë
dhe pakicë.

Ju mirëpresim!

Adresa: Pranë bankës arabe në Shkodër
Mobil: +355 69 20 72142
E-mail: arditbilani@yahoo.com



Disa argumente për besimtarët musliman

Abdulkadir Haktanër

Per besimtarin ka një rendesi të madhe leximi i Kur'anit e cili nuk është një veprim që ka qëllim ta bejë atë hafiz, apo njeri të fese, por duhet të lexohet dhe të mesohet që njeriu të marrë sevape sa me shumë dhe ka si qëllim final që të lexohet për të fituar kenaqesinë e Allahut xh.sh. i cili do t'i sigurojë besimtarit lumturinë e përjetshme në botën tjetër. Te mos harrojmë se feja islame është një diell të cilin nuk mund ta shohe vetëm ateisti dhe mosbesimtari, sepse ata janë larg Kur'anit të Madherueshem dhe larg All-llahut Fuqiplote.

Në debatin e ashpër që ne kemi me ateistet në mund të dalim fiimtare vetëm kur kemi argumente, sepse vetëm me një debat gojor nuk mund të fitohet kjo betejë me materialistet. Feja islame vazhdimisht qëndron përballë armiqësisë dhe egërsirës së atyre grupacioneve fetare dhe politike që bëjnë përpjekje për të penguar ecjen e saj. Besimtari dhe të gjithë të tjerët duhet të jenë të qartë se feja islame nuk është pjesë e politikës, por politika mund t'i shërbe-

je fese, ose mund t'i kundërvihet fese. Prandaj, ka shumë pasoja për besimtarët kur feja perdoret nga politika për të arritur qëllimet e saj. duke perdore mjete dhe argumente të pavetëta me qëllimin e vetëm që muslimanët t'i largojnë nga rruga e Allahut xh.sh. Të vërtetat e Islamit tërësisht janë përmbi politikë. Politika mund t'i shërbejë atij. Në këtë rastë secila politikë e politikan duhet ta dijë kufirin e tij në politikë dhe nuk duhet ta shpërdorojnë fenë. Besimtari ka një momente kur ai e ndjen vehten rehat dhe shumë të qetë duke e kuptuar se ai me shpirtin e tij është aq pranë Allahut xh.sh. Ky moment është namazi i cili e ve njeriun në rrugë të mbare dhe e obligon që të jetë një model i mirë në këto bote duke i shërbyer besimtarit që të rrisë shkallën e perkushtimit dhe të adhurimit ndaj Krijuesit të tij. Është kusht me rendesi që besimtari të thotë vetëm e vërteten dhe të flase gjithmonë vetëm drejtë. Por, duhet të ketë dhe përjashtime për keto qëndrime, sepse ka momente kur ai nuk mund ta thojë të vërteten dhe nuk mund të flase drejt, kur keto qëndrime demtojnë

problemet fetare dhe probleme të tjera të një rendesie të madhe. Besimtari është i ndergjegjshëm se një ditë ai do të vdesë, sepse nuk është i përjetshëm në këto bote dhe nuk mund të jetë shtylla e ekzistencës së kësaj bote. Ai është i brishtë, se është i perbere nga kocka, nga mishi dhe në një moment të caktuar ai mund të zhduket. Prandaj, është me rendesi që ne duhet të pranojmë se jemi kalimtare dhe të perkohshëm në këto bote duke qenë në pritje për të shkuar në botën tjetër ku edhe do të japim llogari për sevape dhe gjynahe që kemi bërë në këto bote. Njeriu në këto bote duhet të bëjë përpjekje që të bëjë vepra të mira që ata të jenë për atë argumentet para për Allahut xh.sh që ai t'i marrë në konsideratë dhe ta shpëtojë këtë njeri nga zjarri i xehnemit. Për njeriun nuk ka rendesi sendet dhe vlerat që ai ka lenë në këto bote, sepse ai duhet të pergaditet për botën tjetër ku do të ballafaqohet me Krijuesin e vet para të cilit ai duhet të japë llogari për ata që ai ka bërë në këto bote. Ai që i ve rendesi në këto jete ahiretit i ka të fituara të dy jetet, dynjane dhe

ahiretin sepse me këto mënyre jetese i bindet urdherave të Krijuesit të vet që e ka udhëzuar se kjo botë është e perkohshme dhe se vetëm bota e ahiretit është jeta e lumturisë së përjetshme. Po të shikojmë me kujdes kthetirat e luanit në do të kuptojmë se ata janë bërë për të coptuar ushqimin e tij dhe kur kemi një frut në dorë e marrim vesh se ai është krijuar për t'u shijuar nga njeriu. Prandaj, kur ne studjojmë aftësinë e njeriut për të përjetuar shpirtërisht situatën e kuptojnë qartë se ai është krijuar që të adhurojë Krijuesin e universit. Është ky shpirt i krijuar nga Allahu xh.sh., pasi është veshur me mish dhe me kocka, ka ardhë në këto bote që ta jetojë atë që të fitojë nesër xhenetin në botën tjetër, sepse ai është dhe mbetet gjithmonë një frut i Universit prapa të cilit është vetë Krijuesi i Gjithesise.

Materiali është pjesë e librit "Aforizmat" i cili do të dalë për besimtarët muslimanë së shpejti.

ALEANCA SHQIPTARO-TURKE NE LUTEN E SHKODRES 1912-1913

Prof. As. Dr. Bajram Xhafa

Me gjithë kërkesën imediate të interesit kombëtar dhe të atij shkencor, tema e luftërave mbrojtëse të shqiptarëve kundër pushtuesve serbo - malazezë dhe grekë vazhdon të mos trajtohet drejt e të ndriçohet plotësisht. Parasëgjithash kjo vlen për Luftën e Shkodrës të viteve 1912 - 1913. Mbrojtja e Shkodrës në historiografinë shqiptare ka qenë lënë në harresë ose është kaluar tangencialisht, me mohime faktesh historike, subjektivizëm e shtrembërime të pafalshme e deri falsifikime flagrante që nuk i pranon logjika elementare dhe ndërgjegja njerëzore, aq më tepër ndërgjegja kombëtare.

Historiani kosovar Xheladin Shala në një kumtesë për këtë ngjarje në Seminarin VI Ndërkombëtar "Shkodra në Shekuj" nëntor, 2005 shkruan: "Kjo epope e lavdishme ishte lënë në harresë për shumë dekada, sidomos në gjysmën e Shqipërisë së robëruar (për faktin se luftoi edhe garnizoni osman në kështjellën e Shkodrës), megjithëse, lirisht mund të themi se, si e tillë, Lufta e Shkodrës ishte shtyllë kryesore e rezistencës kundër pushtuesve serbo - malazez gjatë Luftës së Parë Ballkanike". I njëjti fenomen dhe për të njëjtat motive ka ndodhur edhe në gjysmën e Shqipërisë së "lirë". Për periudhën e Diktaturës kjo kishte shpjegimin e vet: diktatin ideologjik marksist - leninist. Por ky fenomen vazhdon të ndodhë edhe tani pas 18 vjetësh të rënies së sistemit (komunist) dhe të ideologjisë së tij. Prapa botkuptimit marksist - leninist dhe ideologjisë së tij maskohej rryma sllavo - greko - bizantine në historiografinë shqiptare, gjë e cila vazhdon të ushtrojë ndikimin e saj, tashmë pa "kornizën ideologjike". Provë për këtë është botimi më i fundit e më autoritar "Historia e Popullit Shqiptar" III Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2007.

Lufta e Shkodrës 1912 - 1913 u bë "syri i ciklonit" i Luftërave Ballkanike. Marrë në tërësi, Mbrojtja e Shkodrës shqiptare nga sulmet ushtarake serbo - malazeze përbën epopenë më heroike e më madhështore në historinë e luftërave të shqiptarëve, e pa shoqe madje në historinë evropiane. Pas një rrethimi të gjatë e të hekurt që nga fillimi i luftërave në tetor 1912, pas gjashtë muajsh luftë, në fillim të marsit 1913 vazhdonin të qëndronin ende: Shkodra ndaj sulmeve ushtarake serbo - malazeze, Janina ndaj atyre greke dhe Ederneja ndaj ushtrive bullgare. Mihal Grameno shkruan se Shqipëria po shkelej anembanë prej ushtrive greke e serbo - malazeze duke gjetur pengesa "vetëm në kryeqytetet e Shqipërisë, Shkodër dhe Janinë, ku luftonin trimat shqiptarë nën komandë të dy luftëtarëve të mëdhenj, Esat Pashë Toptani dhe Esat Pashë Janina, dy heronj të cilët habitën gjithë botën me burrërinë e tyre që treguan".

Më 6 mars Janina ra në duart e

grekëve. Më 26 mars edhe Ederneja ra në duart e bullgarëve. Në Shkodër dhe rrethin e saj forcat malazeze e serbe vazhdonin sulmet me tërbim për ta pushtuar atë. Në katër frontet e Shkodrës së rrethuar (Tarabosh, Bërdicë - Beltojë, Bardhanjor dhe fusha e Shtojit) vazhdonte qëndresa mbinjerëzore. Nëse Shkodra do t'i qëndronte bombardimit, (siç edhe i qëndroi në të vërtetë - B. Xh.) shkruan E. Durhami, çdo gjë do të varej nga rezervat e ushqimeve për të mos u dorëzuar deri sa të bëhej paqja. "Të ngujuem dhe pa bukë, ishin turq e shqiptarë. Prandej, forcave ndërkombëtare nuk u bahej vonë". Përballë insistimit të Rusisë të mbështetur nga Franca që Shkodra t'i jepej Malit të Zi, në Konferencën e Ambasadorëve qëndronte këmbëngulja e Austro - Hungarisë që ajo t'i mbetej Shqipërisë. Konferenca evropiane e Ambasadorëve zvarriste vendimin që të mbërrinte tek plani sllavo - ruso - frances. Më së fundi, më **22 mars 1913** Konferenca u detyrua të marrë vendimin përfundimtar për kufijtë veriorë e verilindorë. Shkodra i mbeti Shqipërisë. Nuk ka dyshim se vendimtar në marrjen e këtij vendimi ka qenë qëndresa heroike e mbrojtësve të saj. Po kush ishin mbrojtësit e saj?

Mbrojtësit e Shkodrës ishin turq e shqiptarë, ishte aleanca turko - shqiptare. Edhe rezultati përfundimtar i dedikohet kësaj Aleance e cila po shkruante me gjak kapitullin e saj të fundit pas një historie të gjatë bashkëjetese afro 500 vjeçare. Rezultati fatlum dhe i fundit i saj ishte: Shkodra - Shqipërisë. Shkodra, njëra dhe e vetmja nga të katër qëndrat e katër vilajeteve shqiptare të periudhës osmane e të Shqipërisë etnike që i mbeti Shqipërisë. Atje ku kjo aleancë u minua dhe nuk funksionoi pasojat qenë tragjike për popullin e kombin shqiptar: Janina (kryeqendra e Toskërisë), Manastiri dhe Shkupi u pushtuan ushtarakisht, u aneksuan politikisht dhe më pas ndryshuan rrënjësisht fizionominë etnike, kulturore e kombëtare.

Përballë Aleancës Ballkanike, Turqia ishte e vetme. Pas Lidhjes së Prizrenit e sidomos pas Revolucionit xhonturk (1908) pozicioni i shqiptarëve u bë shumë kritik. Veprimtaria politike, agjenturore e diversioniste e fqinjëve dhe vetë politika që ndoqën xhonturqit ndaj shqiptarëve çoroditën shumë qëndrimin e këtyre të fundit.

Kur ushtria malazeze sulmoi në drejtim të Shkodrës, Esat Pasha e çmoi rëndësinë e Kalasë dhe nxitoi në ndihmë të Shkodrës me një divizion rezervë (redif) prej 10 000 burrash, që ishte nën komandën e tij në Elbasan dhe Tiranë. Dedë Sokoli (Coku) i Bregut të Mates me pjesëtarë të fisit të Kelmendit i preu udhën. Esati i urdhëroi ata të njihnin detyrimet e Shqipërisë autonome ndaj Turqisë dhe ta lejonin të kalonte. Kur ai nuk pranoi, Esati u detyrua ta çante rrugën me luftë dhe arriti në Shkodër në kohën e duhur para se t'i prisnin rrugën ushtritë malazeze.

Në luftën për pushtimin e toka-ve shqiptare në skalion të parë të ushtrisë së saj komanda malazeze vinte kryengritësit shqiptarë të Malësisë së Madhe, që me sulmet e tyre të fuqishme morën përsëri më 10 tetor pikëmbështetjen e rëndësishme e të fortifikuar, Deçiçin, ku ngritën përsëri flamurin shqiptar, por menjëherë pas tyre arritën ushtarët malazezë dhe ngritën flamurin e tyre duke thënë "E çliuam ne". Turqit patën shumë të vlarë dhe u larguan me vrap. Nga malësorët pati 52 të vlarë, kryesisht vullnetarë nga Gruda. "Çudia ishte se shqiptarët malësorë myslimanë e katolikë po prijnë shqaun në këtë mësymje të tokës shqiptare. Problem tragjik, inkoshiencë e tmerrshme...". Të dhënat flasin për pjesëmarrjen e 10 - 11 mijë malësorëve në përkrahje të ushtrisë së Malit të Zi. Anglezja Edith Durham që ndiqte zhvillimin e luftimeve në terren, shkruan se "... në frontin tonë të luftës, ushtria malazeze kishte dalë nga prapa Deçiçit, pasi i hapën rrugë të lirë malësorët shqiptarë përmes trojeve të tyre. Për më tepër, burrat e Kastratit e të Shkrelit sulmuan fshatrat myslimane buzë liqenit dhe hapën rrugën...Unë për asnjë çast nuk e besoj se malazezët do të kishin arritur diku afër Shkodrës e ndoshta nuk do ta kishin marrë as Tuzin, sikur malësorët në gusht të mos i kishin detyruar turqit të zbraznin shumë nga postat kufitare e të mos e shkëputnin Tuzin nga të gjitha përforcimet dhe, jo vetëm lejuan ushtritë malazeze përmes krahinës së tyre, por e ndihmuan shumë për të marrë Deçiçin dhe për t'i hapur rrugën që të përparonte".

Një politikë të ngjashme ndoqi edhe Serbia me shqiptarët në Kosovë dhe vise të tjera. Kjo pati pasoja katastrofike për shqiptarët.

Lidhur me qëndrimin ndaj konfliktit mendimi politik shqiptar nuk ishte unik. Gazeta "Liri e Shqipërisë", që përfaqësonte opinionin e kolonisë shqiptare të Sofjes, qysh në fillim të tetorit u drejtohej shqiptarëve me thirrjen: "...të marrin armët dhe të mbrojnë kufijtë e mëmëdheut tonë, duke kërkuar autonominë e Shqipërisë".

Ndryshe e vlerësuan gjendjen kolonitë shqiptare të mërgimit në SHBA. Ato mendonin se Turqia, sidoqoftë u kishte njohur disa të drejta kombëtare, kurse pjesëtarët e aleancës ballkanike synonin ta copëtonin atë krejtësisht. Mbledhja e përfaqësuesve të kolonive shqiptare të SHBA, që u bë më 6 tetor 1912 në Boston, duke "...marrë në sy që po mundet Turqia, shtetet e Ballkanit do ta ndajnë Shqipërinë mes tyre", deklaronte: "Eshtë detyrë e atdhetarëve shqiptarë të jenë plotësisht të bashkuar me guvernën (qeverinë) otomane kundër armiqve të Mbretërisë".

Si funksionoi kjo aleancë në Rrethimin e Shkodrës?

Kur filloi Lufta Ballkanike Shqipëria ishte nën sundimin osman. Padyshim Perandorisë i binte edhe detyra e organizimit të mbrojtjes. Komandant i mbrojtjes së Shkodrës dhe vali ish-

te një gjeneral turk Hasan Riza beu, i zoti dhe trim. Sipas autorit anglez Suajer, Hasan Riza Pasha kishte në dispozicion rreth 14 mijë burra të Divizionit të 24 - t.

Sipas librit "Mbrojtja e Shkodrës" botuar më 1933 të autorëve turq Abdurrahman Nafiz dhe Kiramudin, të dy oficerat shtatmadhorë pranë Hasan Riza Pashës del se ky i fundit përpara se të fillojë Lufta Ballkanike ka kërkuar nga Ministria e Luftës ta ketë pranë Esat Pashë Toptanin për shkak të influencës që gëzonte në shumë krahina të Shqipërisë të cilit i jepet detyra grumbullimit të forcave rezerviste e vullnetare dhe njëkohësisht e komandantit të tyre. Autorët e mësipërm riprodhojnë shënimet e togerit zviceran Karl Egli se "kur asht lirue qyteti, forcat e rregullta e të parregullta kanë qenë 24 000", pra nizamë turq dhe redifë (rezervistë) e vullnetarë shqiptarë.

Në rrethimin e gjatë mbi gjashtë muor të Shkodrës nga forcat serbo - malazeze luftuan sëbashku me nizamët turq edhe rezervistët e vullnetarët shqiptarë. Ky fakt qe mishërimi i natyrshëm i aleancës turko - shqiptare.

Nga Hamdi Bushati morëm njërin nga shembujt e fillimit të bashkëpunimit dhe solidaritetit në atë që u quajt Lufta e Krajës (Taraboshit). Për të pritë rrezikun që i afrohej zonës së fortifikuar të "Taraboshit" një fuqi e rregullt e kësaj zone shkëputet për të ndaluar afrimin e armikut e cila përbëhej prej 3 batalionesh, 1 kompani mitraliere dhe 1 bateri malore. Lufta nisi e ashpër dhe puna shkoi deri në luftim trup me trup midis ushtarëve të batalionit të dytë dhe atyre malazias. Ndërkohë vjen një forcë prej 200 vullnetarësh shqiptarë të Anës së Malit. Kjo betejë që zgjati 6 orë me kacafytyje të përgjakshme, më në fund u kunorëzue me fitoren e ushtrive osmano - shqiptare. Sipas komunikatës së shtabit turk Hamdi Bushati shënon 800 malazez të vlarë kurse statistika e këtyre të fundit shënon: 1538 ushtarë dhe 39 oficerë. Nga ushtria turke 27 të vdekur, 49 të plagosur dhe 4 të humbur. Në këtë luftë ranë dëshmorë edhe disa shqiptarë nga Ana e Malit dhe e Krajës. Autori veçon shkodranin Shaqir Halili i cili luftoi trimërisht në sheshin e luftës përkrah komandantit (turk) Sadedin bej duke derdhur edhe gjakun e tij në shënjë besnikërie të naltë ndaj komandantit hero, për të cilin kishte një simpati jashtëzakonisht të madhe.

Të dy pashallarët, Hasan Rizai dhe Esat Toptani kanë qenë përgjegjës (si bashkëkomandantë) për moszbatimin e urdhërit të armëpushimit të dhjetorit 1912. I pari vali dhe komandant i Mbrojtjes së Shkodrës, përgjegjës për divizionin e rekrutëve turq, për të cilin një gjeneral malazez ka thënë (për Hasan Rizanë): "Ka punuar si ndonjë japonez dhe mbrohet si luan". I dyti përgjegjës për forcat shqiptare që përbënin divizionin e rezervistëve e të vullnetarëve. Aleanca u formatua edhe në komandën unike të dy komandantëve të mbrojtjes.

Një rrethim i gjatë dhe i hekurt, nën breshërinë e bombardimeve të pandërprera të topave e shrapnelave, ditën e natën, me sulme të egra gjithë tërbim, në të ftohtin e dimrit dhe tmerrin e urisë që po kornte pa kursim jetë njerëzish, luftë me armë dhe luftë nervash, krijohen edhe situata shumë të rënda që kërkojnë nerva të forta. Në ditarin e tij korespondenti italian i luftës Gino Berri shkruan edhe për një incident midis dy komandantëve kur në debat e sipër, kërcënimit të Esat Pashës për mungesë trajtimi të redifëve Hasan Riza Pasha i përgjigjet duke nxjerrë dhe drejtuar revolen. Të njëjtën gjë bëri edhe Esati, por ndërhyrja e shpejtë e adjutantëve e shpëtoi katastrofën. Edhe pse incident shumë i rëndë, Aleanca nuk u prish. Nuk u prish as pasi më 30 janar kur Hasan Riza Pasha u vra me atentat. Njësia dhe vazhdimësia e komandës dhe e mbrojtjes së Shkodrës vazhdoi deri në mundësinë e fundit. Tashmë nën drejtimin e Esat Pashës.

Një pamje tjetër e ngjarjeve zhvillohej në frontin grek.

Gjatë tërheqjes (së trupave turke - B. Xh.), - shkruan Eqrem bej Vlora, ish komandant i trupave mbrojtëse territoriale me gradën major në rezervë, - ushtarët nga Shqipëria e Jugut - mjerisht - vranë oficerët turq (gjatë kalimit të qafës së Djavatit) dhe kishin dezertuar. Mbeturinat e armatës së Vardarit u grumbulluan një pjesë

në Janinë, një pjesë u mbërthye në zonat ende të lira të Shqipërisë midis vijës Leskovik - Këlcyre - Gjirokastrë - Delvinë - Sarandë nga njëra anë dhe Durrës - Elbasan - Berat nga ana tjetër.

Pas luftimeve në Grebene, grekët hynë në Mecovë më 9 nëntor 1912 dhe iu afruan Janinës. Gjatë përparimit të tyre, ata nxitën banorët ortodoksë në kryengritje kundër ushtrisë turke. Në fshatrat me popullsi të përzierbënin propagandë që banorët të futeshin në ushtrinë greke. Ushtria greke përparoi drejt Konicës e Leskovikut, rrethoi Janinë, shtiu në dorë Sazanin dhe zbarkoi në Himarë. Në Himarë zbarkuan dy batalione gjiritlinj (vullnetarë grekë nga Kreta) të komanduara nga shqiptari himariot Spiro Spiromilo (Milaj) - kolonel i ushtrisë greke, "në ndihmë të kryengritësve", të cilën e pushtuan bashkë me një varg fshatrash përreth.

Me krijimin e Qeverisë së Përkohshme shqiptare, mjaft nacionalistë shqiptarë mendonin se nuk ishte e nevojshme qëndresa kundër pushtimit grek sepse, sipas tyre, Shqipëria tanimë ishte shtet i lirë dhe i pavarur, i cili dëshiron të jetojë në paqë me të gjithë fqinjët, e në radhë të parë me grekët. Ata kishin bindjen e dyshimtë se përballë marshimit të popujve të tjerë të Ballkanit, mjafton të qëndrojmë *asnjanës* dhe do të fitojmë miqësinë e armiqve të Perandorisë Osmane e do të

sigurojmë ekzistencën e Shqipërisë. Për rrethanat politike të Qeverisë së Përkohshme, kjo ishte një masë paraprake e detyruar, por ishte edhe një propagandë që u shkante për shtat armiqve e që i solli dëme të mëdha Shqipërisë. Për shkak të kësaj propagande diversioniste e me qëllim sabotimi të mbrojtjes së vendit, batalioni i mbrojtjes territoriale u shpërnda. Atëhere grekët pushtuan fshatrat përreth, dogjën shtëpitë dhe e detyruan popullsinë të merrte arratinë.

Ismail Qemali dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë së Përkohshme, - shkruan Eqrem Bej Vlora, - ishin të mendimit se ekzistenca e Shqipërisë varej krejtësisht prej vullnetit të Fuqive të Mëdha. Po të donin ata krijimin e Shqipërisë, do të ishte detyra e tyre t'i çlironin trojet shqiptare nga sllavët dhe grekët, kështu ishte madje e dëmshme që me luftën tonë t'i zemëronim edhe më shumë fqinjët. Ca më tepër, çdo shqiptar i vrarë do të ishte një humbje e kotë për atdheun. Kur dëgjonin propagandën se Shqipëria tani është shtet i pavarur dhe shqiptarët nuk kanë punë me luftërat e turqve, *ushtarët shqiptarë në Vlorë e Berat braktisnin vijën e frontit*. Pa këtë arratisje të ushtarëve shqiptarë, kampi i përforcuar i Janinës do të ishte mbajtur, mbase edhe disa javë dhe ndoshta, kufijtë e Shqipërisë me Greqinë do të kishin marrë një zgjidhje tjetër më të favorshme. *Kjo arratisje e shqiptarëve solli thyerjen e*

vijës mbrojtëse në Çamëri (komandant general brigade Eqren bej Libohova - Arsllan - Pashaliu) dhe Shqipërisë i kushtoi humbjen e Çamërisë, njerës prej krahinave të saj më të bukura dhe më të pastërta etnikisht.

Edhe në Shkodër kishte shfaqje rebelimi të rezervistëve e vullnetarëve por Esat Pashës i duhej të shkante llogor më llogor dhe edhe të pushkatonte ndonjërin nga ata që ishin rebelue nga urija. Redifët, të sjellë nga Durrësi janë të paduruar për një zgjidhje. Ata, gjithsej 15 000 vetë erdhën për mbrojtjen e Shkodrës me kusht që të mos qëndrojnë më shumë se katër javë. Kurse më pak, javët e qendrimit të tyre do të jenë dymbëdhjetë, shkruan Gino Berri në ditarin e tij më 30 dhjetor 1912. Më 7 janar shkruan: "Redifët janë më tepër se asnjëherë të paduruar për t'u kthyer në shtëpitë e tyre. Këtë ua thonë të gjithëve. Patjetër që nisja e tyre do të tregonte fundin e rrethimit. Ata mund të ishin 15 000 veta që do të braktisnin qytetin".

Në takimin e fundit me krerët myslimanë e të krishterë valiu (Esat Toptani) veç të tjerash ju kujton parisë shkodrane shembullin që dha rinia më e bukur e Perandorisë, e ardhur nga viset më të largëta për të mbrojtur qytetin tuaj, juve dhe familjet tuaja.

POROSIA E HASAN EL BENNA

Dëgjoni Vëllezër Muslimanë!

Me këto fjalë do të doja që t'ju përqëndrojmë mendjen tuaj në idenë tonë, sepse mund të na presin momente të rënda, në të cilat dikush, ndonjëherë do të më ndajë nga ju e ndoshta nuk do të mundem që t'ju flas më apo që t'ju shkruaj. Prandaj, po ju porosis që të mendoni mirë për këto fjalë, që t'i mbani mend nëse mundeni dhe të bashkoheni rreth këtyre fjalëve; me të vërtetë secila nga këto fjalë ka në vete një rëndësi të veçantë.

Vëllezër të dashur! Ne jemi një shoqëri bamirëse, nuk jemi parti politike apo organizatë lokale, e cila ka synime të kufizuara. Ne jemi një shpirt i ri i cili rilindi në zemrën e Ummetit tonë dhe i cili e jetëson Kur'anin, ne jemi dritë e re, e cila me njohjen e All-llahut do ta pastrojë dhe do ta ndriçojë errësirën e materializmit, ne jemi zëri rilindës i cili e ringjall misionin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi vesel-lem. Është e vërtetë se, pa e tepruar aspak, duhet të jemi të vetdijshëm se ne e kemi këtë përgjegjësi të cilën e ka lënë bota tjetër.

Nëse dikush ju pyet: "Në çka therrisni ju?", përgjigjuni: Ne therra-

sim në Islamin që i është shpallur Muhammedit alejhis-salam, pjesë përbërëse e të cilit është pushteti, kurse liria është pjesë përbërëse e imperativit të tij. Nëse, atëherë, do t'ju thuhet: "Kjo është politikë!", thuani: "E tërë kjo është Islam dhe ne nuk dimë për ato ndarje!".

Nëse ju thuhet: "Ju thërrisni në revolucion!", përgjigjuni: "Ne thërrasim në të vërtetën dhe paqen, ne besojmë dhe thirrëmi në të!". E nëse ju çoheni dhe na bëheni pengesë në rrugën e misionit tonë, në atë rast All-llahu na lejon që të mbrohemi, a ju do të jeni kundërshtarë të padrejtë. E nëse ju thuhet: "Ju thirrëmi në ndihmën e individëve dhe të organizatës!", thuani: "Ne besojmë në All-llahun, në Atë të Vetmin dhe largohemi nga ajo që ju i përshkruani Atij shok!". E nëse ata me këmbëngulje vazhdojnë në kundërshtime, thuani: "Paqa qoftë me ju! Neve nuk na duhen injorantët!" (Kur'an, 28: 55).

Obligimet

Vëllezër!

Besojeni All-llahun, mburruni me Të, mbështetuni dhe nënshtrojni vetëm Atij! Mos iu frikësoni askujt përveç Tij, zbatoni urdhrat e Tij dhe largohuni nga ndalesat e Tij!

Silluni mirë me njerëzit tuaj, përmbajuni më të mirës, jini të qëndrueshëm dhe të fortë në sjelljet tuaja me atë që All-llahu na ka dhuruar, me fuqinë e një besimtari dhe me dinjitetin e një muslimani!

Lexojeni Kur'anin ashtuqë edhe ta mësoni pastërtinë e jetës së Muhammedit alejhis salam, ashtu që ta kujtoni dhe ta praktikoni Sunnetin e tij, e jo të polemizoni, sepse kur All-llahu e udhëzon një popull, Ai e drejton kah puna, ndërsa secilit popull që ia ka humbur rrugën, pasi është udhëzuar, i është dhënë polemika!

Duajuni dhe kujdesuni ndërmjet veti sa të mundeni ashtu që të lidheni, sepse kjo është sekret i fuqisë sonë dhe garanca e suksesit tonë dhe bëhuni të fortë përderisa All-llahu të gjykojë me drejtësi në mes nesh dhe popullit tonë, e Ai është Gjykatësi më i Drejtë!

Bëhuni të dëgjueshëm e të respektueshëm ndaj udhëheqësve tuaj edhe në sprova edhe në lehtësime, në atë që e keni të dashur dhe në atë që nuk e keni të dashur – ky është simboli i idesë sonë dhe hallka që na lidh neve.

Pastaj, pritëni ndihmën dhe mbështetjen e All-llahut, e cila padyshim se do të vijë: "E atë ditë,

besimtarët do të gëzohen për ndihmën e All-llahut – Ai i ndihmon atij që do dhe Ai është i Gjithfuqishëm, Mëshirues!" (Kur'an, 30: 4-5).

E lus All-llahun që të na udhëzojë në atë që Ai dëshiron dhe në atë në të cilën Ai është i kënaqur, të na drejtojë të gjithëve në rrugën e të zgjedhurve dhe të udhëzuarve, të na japë jetë të ndershme dhe të lumtur dhe të na japë vdekje të muxhahidit dhe të shehidit; vërtet Ai është Mbrojtësi më i mirë dhe Ndihmësi më i mirë!

VINI RE: Imam Hassan el-Benna ra shehid në moshën 42 vjeçare, më 12 shkurt të vitit 1949 në Kajro. Ideja e Vëllezërve Muslimanë është përhapur gjatë jetës së tij ashtu që lëvizja Vëllezërit Muslimanë sot është lëvizja më e madhe islame e cila i mbulon edhe qindra organizata të mëdha apo të vogla të cilat veprojnë me emra të ndryshëm: Vëllezërit Muslimanë, Mlladi Muslimani, Hamasi – lëvizja e rezistencës, Xhema' Islamijja etj. Vëllezërit Muslimanë, si udhëheqës të da'vetit islam, posedojnë një numër të madh të institucioneve bamirëse dhe edukative, spitale, shkolla, universitete, fabrika e kështu me radhë.



**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

- 1- Produkte mishi hallall si:
sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni
por hallalli i vërtetë është vetëm
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENTI"
Cel: 0692101893

**EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT**

ILIRIA

me pronar Haxhij Ilir Muja (aktivist dhe
bamiresh Islam), ju afrohen prodhime nga
me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi.
Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të
larte:

Prodhim dyer e dritare

Dhoma gjumi

Pajisje zyrash

Pajisje kuzhine

Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale

Te gjitha këto me çmime konkurruese
dhe me transport të garantuar falas.
Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeten
te kënaqur. Mund te kontaktoni me
numrin e mobilit: 0692523565



NXITONI NE PUNE TE MIRA

Xhelal ef. Xhemaili

Ifalemenderohemi Allahut xh.sh.krijuesit të gjithësis. Salati dhe selami (shpëtimi dhe paqa) e Allahut xh.sh. qoftë mbi të dërguarin e fundit Muhammed mustafan vulën e të gjithë pejgamberëve, mbi familjen e tij të pastërt, mbi as-habët si dhe mbi të gjithë ata të cilët e ndjekën dhe do ta ndjekin deri në ditën e gjykimit. Vllezër besimtarë! Xhenneti është vend i gjerë i pakufishëm, mbi të gjitha madhështor të cilin e ka përgatitur All-llahu xh.sh. për robërit e Tij të cilët i janë nënshtruar në jetën e kësaj bote dhe i kanë rrespektuar urdhërat e Tij. Ai është shpërblim për besimin e tyre të singertë dhe punët e tyre të mira. Thotë All-lahu i Lartësuar në Kur'anin Fisnik: "Dhe ngutuni (me punë të mira) në falje mëkatesh nga Zoti i juaj dhe për një xhennet gjerësi e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe tokës, i përgatitur për të devotshmit." (Ali Imran-133) Vllezër besimtarë! Edhe na duke qenë gjallë dhe duke jetuar në ket botë kalimtare duhet të mundohemi të punojmë punë të mira, sado që ajo punë të jetë e vogël ose e madhe, atë vepër do ta gjejmë në botën e ardhshme në ditën e gjykimit; kur do të dalim para Madhëris së Allahut Fuqip-lot për të dhënë xhevap-llogari, për të gjitha punët tona që i kemi

punuar në ket bot kalimtare. Vllezër besimtarë! Transmetohet një hadith nga Enesi r.a. se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: "Të vdekurin e përcjellin tri gjëra: familja e tij, pasuria e tij dhe veprat e tij. Dy kthehen kurse një mbetet me te. Kthehet familja dhe pasuria e tij, kurse me të mbesin veprat e tij". Gjithashtu në një hadith tjetër, të cilin hadith e transmeton, Ebu Hurejre r.a. i cili thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Imani (besimi) është 70- e disa degë: Më e vlefshme apo më e madhe është fjala: "La ilahe il-lall-llah", kurse më e ulta është të largojsh nga rruga diçka që i mundon apo i pengon kalimtarët. Edhe turpi është një degë e imanit". Për sa iu përket disa veprave të mira e që njerëzve ju duken shumë punë të vogla ose asgjë, mirëpo te Allahu xh.sh. ato janë shumë vepra të mëdha, do ta përmendim hadithin e pejgamberit s.a.v.s. të cilin e transmeton Ebu hurejre r.a. anhu dhe thotë se i dërguari i Allahut Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: "Një njeri duke udhëtuar në një rrugë e kaplon etje e madhe, e gjen një pus, zbret në të dhe pi ujë. Pastaj del nga pusi dhe e sheh një qen me gjuhë të nxjerrë jashtë që han baltë nga etja. Njeriu thotë: "Këtë qen e paska kapluar etja siç më pat kapluar edhe mua më parë". Pastaj njeriu zbret në pus

dhe mbush këpucën e vet me ujë, pastaj e kap me gojë derisa ngjitet lartë dhe i jep qenit të pijë ujë. All-llahu për këtë e falënderon dhe ia fal mëkatet". (As'habët i) Thanë: "O i Dërguari i Allahut, edhe për kafshët kemi shpërblim?" Pejgamberi i tha po. Ebu Hurejre r.a. po ashtu thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Vërtet e kam parë një njeri duke u dëfryer-u kënaqur në Xhennet për shkak se kishte prerë një dru i cili i pengonte në rrugë duke kaluar muslimanët". Vllezër besimtarë! Edhe ne duhet të angazhohemi -të mundohemi që çdo gjë që bëhet pengesë-pengon njerëzit, duhet ta e largojmë nga rruga nga vendi ku ajo pengon, edhe kjo është një pjesë e imanit, siç e përmendëm në hadithin e Pejgamberit më lartë. Vllezër besimtarë! Duhet gjythysh të rruhem apo të mbrohemi nga gjynahet, dhe të i bëjmë ibadet Allahut Krijuesit të gjithësis, të falim pes kohë namaz, gjythesesi duhet të falim namazin e xhumas rregullisht, sepse pejgamberi s.a.v.s. në një hadith të cilin hadith e transmeton Ebu Hurejre r.a. ku thotë se i Dërguari i All-llahut ka thënë: "Pesë namazet - prej njërit deri te tjetri, namazi i xhumasë - prej njërit deri te tjetri dhe prej një ramazani gjer në ramazanin tjetër, janë pastrues të mëkateve në mes tyre - nëse ruhe-

ni prej mëkateve të mëdha". Gjithashtu një hadith tjetër që transmetohet nga Adij ibn Hatim i cili ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë: "Frikësohuni (ruajuni) nga zjarri i xhehennemit qoftë edhe me gjysëm hurme". Vllezër besimtarë! Ne nga zjarri i xhehennemit mund të mbrohemi vetëm me punë të mira, dhe me ibadet, duke e falemenderuar Allahun dhe duke i bërë tespih vetëm Atij. Ai i cili i nënshtrohet teslim All-llahut xh.sh. bënë vepra të mira dhe i largohet të këqijave këtë njeri do ta shpërblen All-llahu xh.sh. me xhennet gjerësi e të cilit është sa gjerësia e qiejve dhe e tokës, dhe do t'i dhuroj begatimiri të përhershme duke mbetur në të përgjithmonë dhe nuk do të vdesë kurrë. Kurse ai i cili e kundërshton All-llahun e Madhëruar, punon punë të këqia dhe i lenë punët e mira nuk ka dyshim se All-lahu xh.sh. do ta dënon atë për veprat e tia të këqia dhe do ta futë në zjarrin e xhehennemit. Na faltë All-llahu neve të gjithëve. Inshaalla vllezër Zoti na e mundëson që të jemi prej atyre të cilët kur të gabojmë, menjëherë të pendoemi dhe të kërkojmë falje nga Allahu xh.sh. që të na e falë, dhe të falë rahmet mbi neve. E lusim Allahun xh.sh. që të na udhëzon në rrugë të drejtë. Amin.

Joshjet e mashtrimit

Burhan Fili

Mos u mashtroni prej botës gënjeshtare,
Se për besë, për ty s'i jep as pesë pare!
Se sa e sa ka pa si puna e jote:
"Ejani mbas meje", me joshje u thoshte.
Joshjet e botës përkëdhelëse janë,
Si aroma e parfumit t' kënaqun t' bajnë.
Por asht e përkohshme e duhet t' ndërrohet,
Nëse nuk lahet... era s'u durohet.
Rrjedha e jetës si stinët në vijim,
Mbartin me vete joshje e mashtrim;
Mbas tyne ngarendim me frymë t' marrun,
Të dërmuem, t' rraskapitun.. me gjuhë t'dalun...
Por ti, o njeri, kurrë mos u habit,
Mos rri në errësinë por gjej dritë,
Që rrugën e drejtë si duhet ndriçon,
Nga kthetrat e intrigat, ajo, u shpëton.
Pre të joshjeve shpirtin mos e leni,
Kërkoni t' vërtetën... se do ta gjeni.

Jepni zemrës e shpirtit qetësinë e duhur
Mos i braktisni në rrugën plot pluhur.
Saksia e shpirtit lule falso s'pranon,
Lulet e pavdekshme me mall i kërkon..
Qe prej tyne miskun ta prodhojë,
Aroma dhe esenca kurrë mos t'i ndryshojë.
Se trolli i tyne asht vetë Imani,
Ujitja e zhvillimi u vjen nga Islami.
E të dy bashkë ashtu në gërshetim,
I japin njeriut busull për shpëtim.
Kazinotë, klubet, myshteri donë,
Por mysli manët e vërtetë, "sikter!" u thonë.
Dyert ua mbyllin me dyllë të kuq,
Përpjekjet e shejtanit i shkojnë huq.
Me armën e mashtrimit gati të rrinë,
Me veshin intrigues gjithmonë n'përgjim...
Kush asht myshteri i Kur'anit madhështor,
E pakta hallall xhevahir në kunorë!

Në vete i kënaqun, në familje gëzim,
Në botë lumtuni, në ahiret shpëtim.
Pre e joshjeve t' botës ai kurrë s' bie.
Nje gja e tillë as n' shprehje s'vjen.
Ndjekja e modave e lloj-lloj makiazhi
Si n'shkretinë i eturi vrapon mbas mirazhit.
A kjo asht jeta për të cilën je krijue!?
Mirësitë e saja ende s'i ke shijue.
Se lezeti dhe shija t' janë kthye në hidhnim,
Pastroje gjuhën e shijimit që t'kesh shpëtim.
Kthimi te Allahu ta jep atë mundësi,
Atëherë do e kuptosh se vetë je mirësi,
Dhe atëherë në atë botë do ta kuptosh,
Se je ai që duhet t'jesh ejeten do ta gëzosh.
Lutju Allahut me zemër e shpirt,
Që në udhën tande të hedh dritë.
Çdo gja që të duhet e gjen n'Kur'an,
Shembull t' përkryem ke Mustafan!

MUSLIMANIZMI DHE EVROPIANIZMI

Fatos Lubonja

Megjithë këtë presion prej një shekulli vektorializëm e modernizim të identifikuar me “kapërcimin e prapambetjes që na lanë turqit” për habinë e atyre që mendonin se komunizmi, me gjithë të zezat e pafundme, kishte bërë edhe një të mirë, sepse kishte zhdukur të gjitha fetë dhe kështu, tani, do të mundësonte kthimin e shqiptarëve në fenë e të parëve (dmth. në fenë e krishterë) kjo gjë nuk ndodhi. Një pjesë e shqiptarëve iu kthyen fesë muslimane. Shkaqet, siç thashë, kanë qenë të shumta, por mbizotërues ka qenë nevoja për fe dhe Zot, e cila i ka çuar në fenë e stërgjyshërve të tyre muslimanë, sepse, sikurse dihet, feja është një akt iracional besimi me rrënjë të thella në emocionet e njeriut. Nuk është një akt racional kalkulimi, një mekanizëm mbijetese i shqiptarit, i zgjedhur në mënyrë racionale, siç u tha shpesh në debatet mbi librin. Dua të them se një pjesë shqiptarësh muslimanë, që kërkonin Zotin dhe besimin, e kanë ndjerë shumë më afër atë në fenë e të parëve të tyre muslimanë, sesa tek të krishterët. Dhe besoj se kjo është pjesa e besimtarëve. Kurse ndërrimin e emrave të atyre që shkojnë në Greqi që vërteton, megjithatë, se ndodh edhe fenomeni i veshjes së një identiteti tjetër për mbijetesë, sipas meje duhet ta shohim më shumë si një aspekt tjetër të fenomenit të krizës së identitetit e personalitetit të shqiptarit të komunizmit, që, kombinuar me individualizmin e konsumizmin, po krijon një shqiptar tjetër të ndryshëm nga të gjitha kohët paraardhëse dhe që, nga pikëpamja fetare, të paktën në këtë brez, qëndron më larg feve qoftë muslimane qoftë të krishtera. Megjithatë kjo kategori duket më indiferente ndaj këtij debati. Debatin e bëjnë ato shtresa që janë më të ndjeshme ndaj çështjes së identiteteve, që ndonëse janë një pakicë, dominojnë skenën e konstruktimit të ndërgjegjeve dhe identiteteve të reja. Gjykimi im, duke u nisur edhe nga debati mbi librin e Blushit, është se në kohën kur po jetojmë, siç e kam shkruar edhe herë tjetër, miti i tolerancës fetare që ka siguruar bashkëjetesën në paqe midis këtyre komuniteteve, nuk mjafton për të siguruar vazhdimësinë e harmonisë midis komuniteteve fetare në terma afatgjata. Së

pari duhet thënë se, në fakt, gjatë periudhës komuniste nuk u zhvillua kultura e tolerancës, por kultura e intolerancës. Feja nacional komuniste e Hoxhës i shtypi fetë e tjera, nuk i toleroi, dhe nuk krijoi kulturën e vërtetë laike të bashkjetesës dhe respektit të të ndryshmeve, por shqiptarizmin e interpretoi si një identitet monolitik dhe përjashtues identitetesh të tjera. Në vazhden e këtij shqiptarizmi monolitik e përjashtues, të lënë trashëgim nga komunizmi, me rilindjen e feve thënia “feja e shqiptaria është shqiptaria” filloi të zëvendësohet me mitin e tolerancës fetare i cili, në fakt, ishte më shumë një konstrukt ndrydhës (Frojdi thotë “Qytetërimi është ndrydhje”) që nuk kishte frymë laike, por laiciste. Me laicizëm kam parasysh një laicitet të deformuar që vjen e bëhet një religjion integrist. Sipas këtij laicizmi, identitetet fetare tashmë mund të jetonin, por duhet të qëndronin nën sundimin e shqiptarizmit që i konsideronte ato si inferiore. Mirëpo ky lloj laicizmi i mbuluar me mitin e tolerancës fetare sot rezulton i dobët për t’iu imponuar identiteteve të tjera. Kjo, së pari sepse jetojmë në kohën pasnacionaliste, të krizës së shtetit komb të krijuar nga globalizmi që i ka dobësuar ndjenjat kombëtare, së dyti sepse jetojmë në kohën kur modernizmi dhe kulti i modernizmit, që kuptohet edhe si triumf i epokës së arsyes mbi atë të besimit, janë në krizë, ia kanë lënë vendin post-modernizmit që, mes tjerash shfaqet, edhe si një rikthim i feve. Së treti sepse jetojmë në kohën pas 11 shtatoriste të luftës kundër terrorizmi islamik që fut në kontradiktë ideologjinë e perëndimorizmit me qënien e shqiptarëve me shumicë muslimane. Dhe këtu shohim të lindë kontradikta që sipas meje janë edhe në qendër të debatit të librit të Blushit. Kësaj situate të re, pas-nacionaliste, pas-moderniste e pas - 11 shtatoriste një pjesë e mirë e inteligjencës, ku bën pjesë edhe Blushi, kërkojnë t’i përgjigjen me metoda të vjetra nacional - romantike e nacional - komuniste, duke tentuar ta rikonstruktojnë shqiptarizmin me metodat romantike të rigjetjes së thelbit identitar të shqiptarit, në këtë rast nëpërmjet bashkimit të rrënjëve të krishtera me perëndimorizmin dhe me imponimin e këtij identiteti të ri. Blushit nuk i intereson feja, as nuk e njeh botën

e saj, ashtu sikurse nuk njeh historinë, atij i intereson të bëjë politika rikonstruksioni identitar. Blushi bën pjesë ndër ata që ndonëse jobesimtarë, madje do të thoja edhe ateistë, nisur nga një qasje ideologjike vektorializmi, e denigron fenë islame nëpërmjet shumë kliševe që janë përdorur nga vektorializmi shqiptar, të paktën që nga koha e Naimit e deri tek kinematografia e letërsia e socrealizmit. Vënë alarmin e muslimanizmit të një pjese, ndërkohë që nuk venë alarmin për kthimin e pjesës tjetër në ortodoksi apo katolicizëm, por ekzaltojnë rrënjët kristine të shqiptarëve. Cilët janë problemet e këtij qëndrimi, sipas meje? Kjo qasje krijon një ndarje të rrezikshme në vend midis shqiptarësh të dorës së parë dhe shqiptarësh të dorës së dytë. Dhe këtu Blushi nuk është se po bën ndonjë gjë të re sepse modelet i kemi jo vetëm në të kaluarën tonë, por edhe në Evropën e sotme. Ai kërkon të imitojë edhe qëndrime ekstremistësh të djathtë të sotëm në Evropë. Por me një ndryshim të madh, sepse, ndërsa në Evropë këtë e bëjnë të djathtët konservatorë ndaj emigrantëve muslimanë me pretendimin se përfaqësojnë shumicën e krishterë dhe bazuar në faktin historik se Evropa ka një komponente të rëndësishme të kulturës së saj dhe të historisë së saj kristiane katolike dhe protestane, tek ne historia dhe përkatësia është krejt tjetër shumë më e lidhur me Lindjen dhe kulturën e saj bizantine dhe osmane dhe me fenë muslimane dhe, mbi të gjitha, sepse muslimanët nuk janë emigrantë, por shqiptarë vendas dhe shumicë. Sipas mendimit tim të shprehur edhe herë tjetër, qasja ndaj identiteteve dhe rrënjëve në funksion të ndërtimit të një identiteti të kohës ku jetojmë duhet të jetë tjetër nga kjo qasje përjashtuese dhe diskriminuese. Shembullin e kemi në Evropë, ku shumica dhe pjesa më intelektuale, e aq më tepër partitë ku bën pjesë simotrat e partisë ku militon Blushi, e kanë refuzuar përcaktimin e identitetit evropian mbi bazët e rrënjëve fetare të krishtera. Qasja sipas meje në kohën e sotme duhet të jetë tjetër nga konstruksioni i një shqiptarizmi të bashkuar me “rrënjët” e krishtera, madje edhe nga laicizmi i kamufluar me mitin e tolerancës fetare. Qasja duhet të jetë ndërtimi i një shoqërie me frymë laike dhe hapje drejt mundësisë që e vërteta

mund të jetë tjetërkund dhe heqje dorë nga imponimi me forcë i përmbajtjeve që nuk gjejnë konsensusin e tjetrit.” Shqipëria në një farë kuptimi, pikërisht në sajë të ekzistencës së saj në një pikë gjeopolitike e kulturore që ka përbërë edhe një udhëkryq qytetërimesh, është një miniatyrë e problematikës globale. A duhet t’i mendojmë si të rreshtuar në aleanca që konfliktojnë rreth vizionesh alternative të së mirës dhe së keqes të frymëzuara nga fetë? Apo duhet të imagjinojmë që këto qytetërime do të kultivojnë një diskurs «ndërkulturor» rreth principeve të një bashkekzistence paqësore midis të barabartësh? Dhe në këtë diskurs ndërkulturor a nuk duhet të imagjinojmë se pjesët duhet të bëjnë një hap prapa ndaj pretendimit se e vërteta e tyre është e vetmja e vlefshme? A nuk duhet të fillojmë të imagjinojmë se duhet të mësojmë të përdorim vetëm argumentet që i pranojnë edhe ata që nisen nga një pikëpamje tjetër nga e jona? Dhe a nuk është pikërisht kjo: “distanca refleksive” nga të vërtetat tona ajo që duhet të kuptojmë si “laicitet”? Arsyeja laike europiane rikthehet kështu – sipas Habermasit - në qendër të skenës si model i konfigurimit të atij që mund të jetë etosi ndërkulturor i një shoqërie botërore në të cilën takohen qytetërime të ndryshme.

Ky do të ishte edhe modeli më i mirë sipas meje i Shqipërisë së shekullit XXI, fati historik i së cilës ka bërë që në territorin e saj të bashjetojnë tre fe dhe tre kultura. Shqipëria ka plot monumente të tilla që bëjnë thirrje për paqe dhe harmoni midis të ndryshmeve, për diskursin ndërkulturor midis tyre, për faktin se kjo larmi është pasuri që duhet ruajtur dhe jo rrezik që duhet eliminuar. Ajo e gjitha me historinë e saj të veçantë mund të ishte një monument i tillë, por për fat të keq, deri më sot, politikat ku i mësohet argumenteve të paprahuara nga pala tjetër e ku të vërtetat e njërës dhunojnë ato të tjetrës, që i ushqen edhe libri i Blushit, që u bë shkas për këto dy shkrime, kanë dominuar duke sjellë dhunë, shkatërrim e përjashtim më shumë sesa paqe, harmoni dhe bashkim midis shqiptarëve.